

K O N K L U Z I O N

Nr.09-705/1 dt. 09.11.2017

**PËR SHPALLJEN E AKTVENDIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT
DHE ANËTARËVE TË KOMISIONIT VERIFIKUES**

1.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet aktvendimi për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit verifikues, miratuar nga Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 1^{re} konstituive dt. 06.11.2017.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

A K T V E N D I M
Nr. 08-694/3 dt. 06.11.2017
PËR ZGJEDHJE TË KRYETARIT DHE ANËTARËVE
TË KOMISIONIT VERIFIKUES

2.Në mbështetje të nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM”nr.5/02) si dhe nenit 9 paragrafi 2 të Rregullores së Këshillit të Komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 4/05),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e parë konstituive dt. 06.11.2017 vendosi:

1.Këshilli i Komunës zgjedh komisionin verifikues në përbërje:

- | | | |
|------------|-----------|-------------|
| 1. Fuat | Spahiju | -kryetar |
| 2. Ilirjan | Fetahu | -anëtar dhe |
| 3. Azem | Fejzovski | -anëtar |

2.Detyrë e komisionit verifikues është që mbi bazën e Çertifikatave të lëshuara nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve për zgjedhje anëtar i Këshillit dhe verifikimit të identitetit të këshilltarëve, të përgatit dhe jep raport Këshillit me propozim për verifikimin e mandatit anëtarëve të pranishëm të Këshillit të Komunës.

3.Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpalljet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryesuesi ,
Eugjen Cami d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-705/2 dt. 09.11.2017

**PËR SHPALLJEN E VENDIMIT PËR VERIFIKIMIN E MANDATIT
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR**

3.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet vendimi për verifikimin e mandatit anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 1^{re} konstituive dt. 06.11.2017.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

V E N D I M
Nr. 08-694/4 dt. 06.11.2017
PËR VERIFIKIMIN E MANDATEVE
ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

4.Në mbështetje të nenit 59 të Statutit të Komunës së Dibrës (“Kumtesa zyrtare e Komunës “nr.14/03) në lidhje me nenin 7 të Rregullores së punës së Këshillit (“Kumtesa zyrtare e Komunës “nr. 4/05) me propozim të komisionit verifikues,

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e parë konstituive dt.06.11.2017 vendosi:

Neni 1

Verifikohen mandatet anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër të zgjedhur në zgjedhjet lokale të dt. 15 tetor 2017 dhe ate:

Abdija	Mersovski
Afrim	Maqellara
Afet	Avmedoski
Albiona	Riza
Armen	Neziri
Azem	Fejzovski
Bashkim	Mashkulli
Doruntina	Cami
Emina	Muslioska
Eugjen	Cami
Fisnik	Mela
Fuat	Spahiju
Hekuran	Duka
Ilirijan	Fetahu
Mirela	Korumi

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të komunës”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryesuesi,
Eugjen Cami d.v.

K O N K L U Z I O N
Nr.09-705/3 dt. 09.11.2017
PËR SHPALLJEN E AKTVENDIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT
TË KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

5.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet aktvendimi për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Komunës Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 1^{të} dt. 06.11.2017.

KOMUNA DIBËR
Kryetari,
Ruzhdi Lata d.v.

A K T V E N D I M
Nr.08- 694/5 dt. 06.11.2017
PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
KËSHILLIT TË KOMUNËS DIBËR

6.Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit për vetadminstrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 5/02) si dhe nenit 22 të Statutit të Komunës Dibër, (“Kumtesa zyrtare e komunës”nr.14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e parë dt. 06.11.2017 vendosi:

1. Për kryetar të Këshillit të Komunës Dibër nga rradhët e anëtarëve të Këshillit, i cili do të udhëheqë me punët e këtij Organi për mandat 4 vjeçar, zgjidhet **BASHKIM MASHKULLI**.
2. Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Kumtesën zyrtare të Komunës.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryesuesi,
Eugjen Cami d.v.

K O N K L U Z I O N

Nr.09-705/4 dt. 09.11.2017

**PËR SHPALLJEN E AKTVENDIMIT PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT
DHE ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE MANDATI,
ZGJEDHJE DHE EMËRIME**

7.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

K o n k l u d o i

Shpallet aktvendimi për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për çështje mandati,zgjedhje dhe emërimë, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e 1^{re} dt. 06.11.2017.

KOMUNA DIBËR

Kryetari,

Ruzhdi Lata d.v.

A K T V E N D I M
Nr. 08-694/6 dt. 06.11.2017
PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT DHE ANËTARËVE TË
KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE
MANDATI, ZGJEDHJE DHE EMËRIME

8.Në mbështetje të nenit 32 të Ligjit për vetadministrim lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 5/02), si dhe nenit 22 të Rregullores së Këshillit të Komunës (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.4/05),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e parë dt. 06.11.2017 vendosi:

1.Në komisionin për çështjet e mandatit, zgjedhjeve dhe emërimeve si komision i përhershëm pranë Këshillit të komunës Dibër zgjidhen:

Për kryetar

-Fuat Spahiu

Për anëtarë

- Hekuran Duka
- Anëtar i Aleancës për Shqiptarët
- Azem Fejzoski
- Afet Avmedoski

3.Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën Zyrtare të Komunës Dibër”.

KËSHILLI I KOMUNËS
Kryetari,
Bashkim Mashkulli d.v

P Ë R M B A J T J A

1	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit verifikues	_____	1
2	Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit verifikues	_____	2
3	Konkluzion për shpallje të vendimit për verifikimin e mandatit anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër	_____	3
4	Vendim për verifikimin e mandatit anëtarëve të Këshillit të Komunës Dibër	_____	4
5	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Komunës Dibër		5
6	Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit të Komunës Dibër	_____	6
7	Konkluzion për shpallje të aktvendimit për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për çështjen e mandatit,zgjedhjeve dhe emërimeve	_____	7
8	Aktvendim për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit për çështjen e mandatit,zgjedhjeve dhe emërimeve	_____	8

PËRGATITI : SHËRBIMI PRANË KËSHILLIT

=====